

FESTIVALI I ARTIT NË **HA** PËSIRË
PU BLIKE



Edicioni i dhjetë
28-31 Gusht 2024
Prishtinë, Kosovë

hapu.me   hapufest



Hapu, zbulo dhe rizbulo!

Të nderuar zbulues dhe eksplorues,
Është hera e dhjetë! Po hapemi, edhe një herë po e rizbulojmë Prishtinën. Në shumë pika anembanë qytetit, ju ftojmë të zbuloni ide kuptimplota dhe të guximshme, shqetësime si dhe të rizbuloni qoshet, vendet dhe hapësirat e Prishtinës. Këtë po e bëjmë me artistë nga Evropa dhe Bota, me partneritetin tonë me IN SITU dhe partnerët, tashmë që 13 vite.

Ne po transformojmë përkohësisht hapësira që vizitorët të rizbulojnë veten e tyre dhe atë që i rrethon. Në një barnatore përkohësisht të instaluar të Eva Bublë në Pallatin e Rinisë do të mund të zbuloni kurat e Nënës Natyrë për njerëzit dhe format e jetës më shumë se njerëzore. Ju mund të përjetoni tingujt e Donika Rudit që thërrasin zëshëm për ndikimin kritik të ndotjes së ajrit në shëndetin tonë dhe mjedisin. Takohuni me Atlasin, kllounin në rrugës Nënë Tereza dhe rizbuloni se si të miqësoheni me pëllumbat, drunjtë dhe krijesat e tjera.

Këtë herë, ju ftojmë të zbuloni poezinë dhe lozonjaren e rrugës Nënë Tereza përmes [Kornizës] të Electrico28, ku jeni të ulur në një karrige, të privilegjuar me atë që vetëm ju mund të dëgjoni prej përditshmërisë që ndodh. Më vonë, ndaluni, mendoni për një çast dhe rizbuloni atë që Juan Ignacio Tula zbuloi përmes rrotullimit të përsëritur të rrotës së tij, duke na udhëhequr në një kërcim dervishësh dhe në një kërkim të pafund për të përbashkëtën universale dhe personale.

Nëse doni të ndani bashkërisht, atëherë hapuni, ndani me ne një gjest, zbuloni Sauf Le Dimanche dhe ata do t'ju kthejnë një kërcim të

veçantë vetëm për ju, duke rizbuluar gjestin tuaj. Ata po e ndajnë kërcimin e tyre bashkërisht edhe me miqtë tanë në Shtëpinë e të moshuarve, duke rizbuluar baladën, ku secili gjen ritmin e tij e të saj në një puhizë të lehtë kërcimi. Një kujtim, përjetësia dhe fundshmëria mund të rizbulohen me Cristina Madonaldo në Parkun e Qytetit, ku në një ambient të rehatshëm mund të përfshiheni së bashku në një udhëtim të brendshëm përplot me zbulime.

Rizbulimi i bashkëbanuesve të hapësirës sonë publike, të bashkëqytetarëve nuk mjafton asnjëherë. Këtë herë ju ftojme në ODA, në një mjedis më të strukturuar për të rizbuluar të përbashkëtën me të panjohurit. E krijuar nga 600 Highwaymen, ky akt i mbledhjes është një përjetim i dirigjuar nga kartolinat dhe i inskenuar nga ju dhe njerëzit e tjerë që i takoni në hapësirën tonë të përbashkët të jetës tonë të përditshme.

Jemi shumë të lumtur që mund t'ju propozojmë shumë mënyra zbulimi e rizbulimi. Hapuni, ejani jashtë dhe frymëzohuni, na zbuloni në shumë vende e kohë të ndryshme të shtrira në programin tonë. Mezi po presim për këtë bashkë-rrugëtim zbulues që do të mbahet mend.

PROGRAMI

E mërkurë, 28 gusht 2024

Ora	Programi	Lokacioni
nga ora 10:00	Sauf Le Dimanche (FRANCË) - BALADË <i>Një performancë koreografike për shtëpitë e të moshuarve. Një dyshe kërcimtaresh nga Franca kalojnë dy ditë për t'i dhënë gjithsecilit hapësirë për të gjetur ritmin e tij apo të saj.</i>	8
12:00 deri 18:00	Eva Bubla (HUNGARI) - LABORATORI MIKROBIAL I SË ARDHMES <i>Një laborator udhëtues, një koleksion i ilaçeve të së ardhmes, trajtimeve, riteve dhe narrativeve që pasqyrojnë mbi mirëqenien e formave të jetës njerëzore dhe atyre më shumë se njerëzore. Përgjatë HAPU-s, barnatorja e përkohshme e Laboratorit shfaq koleksionin e ilaçeve dhe trajtimeve.</i>	6
15:00	600 HIGHWAYMEN (Nju Jork, SHBA) - MIJËRA MËNYRA: NJË ASAMBLE <i>Ky projekt i veçantë për të panjohurit përdorë një skenar të përbashkët, ku 16 anëtarë të publikut bashkohen për një orë për të ndërtuar një rrëfim evokues të këmbëngulësisë dhe rrëimit. Për rezervimin e vendit ju lutem na shkruani në teatridoda@gmail.com me ditën që dëshironi të merrni pjesë.</i>	1
16:00	Florent Golfier (ÇEKI) - ATLAS <i>Shkoni dhe zbuloni Kllounin Atlas, para Ministrisë së Kulturës në Nëna Tereze, në zyrën e tyre të improvizuar dhe shkoni për një ecje të shoqëruar prej rreth 60 minutash për të mësuar më shumë rreth aktivizmit të kllounëve, si të miqësoheni me pëllumbat, drunjat dhe krijesat e tjera.</i>	2
16:30	ELECTRICO 28 (SPANJË, AUSTRI) - [KORNIZA] <i>Uluni përballë jetës së përditshme për ta vëzhguar atë. [Korniza] ka të bëjë me shumë specie të hapësirave, në mënyrë lozonjare dhe poetike ajo përpiqet të kap gjithçka që ndodh për 50 minuta, pa skenar dhe pa përfundim.</i>	2
18:30	<i>Për rezervimin e vendit ju lutem na shkruani në teatridoda@gmail.com me ditën dhe orën që dëshironi të merrni pjesë.</i>	

20:30	Donika Rudi (KOSOVË, BELGJIKË) - OKUPO AJRIN (Vajtimi i Tokës II)	4
21:00	<i>Pjesa e dytë e ciklit audio-vizual "Vajtimi i tokës", "Okupo ajrin" trajton çështjen dhe veprimin urgjent kundër ndotjes së ajrit dhe shmangien e ndryshimeve klimatike, frymëzuar nga shiritat e ngrohjes që përfaqësojnë rritjen e temperaturave globale ndër vite.</i>	
21:30	<i>Kohëzgjatja është 10 minuta.</i>	

E enjte, 29 gusht 2024

Ora	Programi	Lokacioni
nga ora 10:00	Sauf Le Dimanche (FRANCË) - BALADË <i>Një performancë koreografike për shtëpitë e të moshuarve. Një dyshe kërcimtaresh nga Franca kalojnë dy ditë për t'i dhënë gjithsecilit hapësirë për të gjetur ritmin e tij apo të saj. Sot, në fund të kësaj përvoje, të gjithë janë të ftuar të mblidhen për të parë një performancë 30-minutëshe.</i>	8
12:00 deri 18:00	Eva Bubla (HUNGARI) - LABORATORI MIKROBIAL I SË ARDHMES <i>Një laborator udhëtues, një koleksion i ilaçeve të së ardhmes, trajtimeve, riteve dhe narrativeve që pasqyrojnë mbi mirëqenien e formave të jetës njerëzore dhe atyre më shumë se njerëzore. Përgjatë HAPU-s, barnartorja e përkohshme e Laboratorit shfaq koleksionin e ilaçeve dhe trajtimeve.</i>	6
18:00	<i>Punëtorja e Mjekësisë së të ardhmes fton publikun të spekulojë bashkërisht për të ardhmen e Prishtinës duke dizajnuar rite dhe ilaçe të reja për format e ndryshme të jetës që e popullojnë atë.</i> <i>Ju lutemi rezervoni vendin tuaj duke na shkruar në teatrioda@gmail.com me ditën dhe orën që dëshironi të merrni pjesë ne punëtori.</i>	
15:00	600 HIGHWAYMEN (Nju Jork, SHBA) - MIJËRA MËNYRA: NJË ASAMBLE <i>Ky projekt i veçantë për të panjohurit përdorë një skenar të përbashkët, ku 16 anëtarë të publikut bashkohen për një orë për të ndërtuar një rrëfim evokues të këmbëngulësisë dhe rrënimit. Për rezervimin e vendit ju lutem na shkruani në teatrioda@gmail.com me ditën që dëshironi të merrni pjesë.</i>	1

16:00	Florent Golfier (ÇEKI) - ATLAS Shkoni dhe zbuloni kllounin Atlas, para Ministrisë së Kulturës në Nëna Tereze, në zyrën e tyre të improvizuar dhe shkoni për një ecje të shoqëruar prej rreth 60 minutash për të mësuar më shumë rreth aktivizmit të kllounëve, si të miqësoheni me pëllumbat, drunjte dhe krijesat e tjera.	2
16:30	ELECTRICO 28 (SPANJË, AUSTRI) - [KORNIZA] Uluni përballë jetës së përditshme për ta vëzhguar atë. [Korniza] ka të bëjë me shumë specie të hapësirave, në mënyrë lozonjare dhe poetike ajo përpiqet të kap gjithçka që ndodh për 50 minuta, pa skenar dhe pa përfundim.	2
18:30	Për rezervimin e vendit ju lutem na shkruani në teatrioda@gmail.com me ditën dhe orën që dëshironi të merrni pjesë.	

E premte, 30 gusht 2024

Ora	Programi	Lokacioni
nga ora 11:00	BISEDË ARTISTËSH Në ambientet e Institutit Francez në Prishtinë, bashkëbisedojmë me Sauf Le Dimanche - duon nga Franca, kërcimtaret Emilie Buestel dhe Marie Doiret rreth punës së tyre në hapësirë publike, skenën kulturore në Francë si dhe përvojave të tyre artistike e sociale në Francë e në Kosovë.	9
12:00 deri 18:00	Eva Bubla (HUNGARI) - LABORATORI MIKROBIAL I SË ARDHMES Një laborator udhëtues, një koleksion i ilaçeve të së ardhmes, trajtimeve, riteve dhe narrativeve që pasqyrojnë mbi mirëqenien e formave të jetës njerëzore dhe atyre më shumë se njerëzore. Përgjatë HAPU-s, barnatorja e përkohshme e Laborarit shfaq koleksionin e ilaçeve dhe trajtimeve.	6
18:00	Punëtorja e Mjekësisë së të ardhmes fton publikun të spekulojë bashkërisht për të ardhmen e Prishtinës duke dizajnuar rite dhe ilaçe të reja për format e ndryshme të jetës që e popullojnë atë. Ju lutemi rezervoni vendin tuaj duke na shkruar në teatrioda@gmail.com me ditën dhe orën që dëshironi të merrni pjesë ne punëtori.	

15:00	<p>600 HIGHWAYMEN (Nju Jork, SHBA) - MIJËRA MËNYRA: NJË ASAMBLE</p> <p><i>Ky projekt i veçantë për të panjohurit përdorë një skenar të përbashkët, ku 16 anëtarë të publikut bashkohen për një orë për të ndërtuar një rrëfim evokues të këmbëngulësisë dhe rrëimit. Për rezervimin e vendit ju lutem na shkruani në teatrioda@gmail.com me ditën që dëshironi të merrni pjesë.</i></p>	1
16:30	<p>Sauf Le Dimanche (FRANCË) - TROK!</p> <p><i>Dhuro një gjest te këcimtaret, ato frymëzohen dhe ju dhurojnë një kërcim. Kjo kohë intime prej 1 minutë e 30 sekondash është posaçërisht për ju. Eja dhe përfjetoje këtë takim dhe takohuni me duon e kërcimtareve nga Franca.</i></p>	5
15:00	<p>Florent Golfier (ÇEKI) - ATLAS</p> <p><i>Shkoni dhe zbuloni kllounin Atlas, para Ministrisë së Kulturës në Nëna Tereze, në zyrën e tyre të improvizuar dhe shkoni për një ecje të shoqëruar prej rreth 60 minutash për të mësuar më shumë rreth aktivizmit të kllounëve, si të miqësoheni me pëllumbat, drunjtë dhe krijesat e tjera.</i></p>	2
17:30	<p><i>Bashkëngjiteti me kllounin Atlas, në ditën e fundit për një ritual performativ do të kremtojë përfundimin e vizitës së Atlasit në Prishtinë.</i></p>	
18:30	<p>Sauf Le Dimanche (FRANCË) - TROK!</p> <p><i>Dhuro një gjest te këcimtaret, ato frymëzohen dhe ju dhurojnë një kërcim. Kjo kohë intime prej 1 minutë e 30 sekondash është posaçërisht për ju. Eja dhe përfjetoje këtë takim dhe takohuni me duon e kërcimtareve nga Franca.</i></p>	2
19:00	<p>Juan Ignacio Tula (FRANCË, ARGJENTINË) - L'INSTANT T!</p>	3
21:00	<p><i>Një eksplorim i thellë me objektin e tij të obsesionit, rrotën. Mes trazirave të kërcimit, ai zhytet në një ekstatë, një gjest i cirkut na drejton drejt një kërcimi dervishësh.</i></p>	

E shtunë, 31 gusht 2024

Ora	Programi	Lokacioni
10:30	Cristina Maldonado (ÇEKI, MEKSIKO) - LOJA E PAFUNDME <i>Bashkohuni lojës në të cilën nuk ka humbës apo fitues, lojës që nuk ka fillim apo fund! Një meditim prej 60 minutash, me përfshirje në një udhëtim të brendshëm përmes përvojave dhe historive të mbledhura në vende të ndryshme. Një meditim mbi kujtesën, përjetësinë dhe fundshmërinë.</i>	6
12:30		
16:00	<i>Për të rezervuar vendin tuaj, ju lutemi na shkruani në teatrioda@gmail.com me një shënim për orën e dëshiruar për ju.</i>	
21:00	Juan Ignacio Tula (FRANCË, ARGJENTINË) - L'INSTANT T! <i>Një eksplorim i thellë me objektin e tij të obsesionit, rrotën. Mes trazirave të kërcimit, ai zhytet në një ekstatë, një gjest i cirkut na drejton drejt një kërcimi dervishësh.</i>	3
21:30	Koncerti përmbyllës i edicionit të dhjetë të HAPU. Performojnë: ZWADA <i>Muzikë jo statike e eksperimentale. Duke rrjedhur plotësisht nëpër rrymat e muzikës, festojmë mbledhinë e sivjetme të artistëve, miqve e shikuesve nga Kosova dhe Bota. Të gjithë janë të ftuar!</i>	1

LOKACIONET E FESTIVALIT:

1

Teatri ODA - Pallati i Rinisë, nr. 111 (rr. Rinia, 7)

<https://maps.app.goo.gl/KMgcbKEza42NHqRAA>

2

rr. Nëna Tereze (te Ministria e Kulturës)

<https://maps.app.goo.gl/Reqw7S6YJnB2a88L9>

3

Sheshi Zahir Pajaziti (Amfiteatri)

<https://maps.app.goo.gl/gGxeL5cBGUq9mynn6>

4

Pallati i Rinisë - Shkallët brenda qendrës tregtare

<https://maps.app.goo.gl/J5wG4GQ4qnwSEnCG8>

5

Sheshi Zahir Pajaziti (para hotelit Grand)

<https://maps.app.goo.gl/5VFntxCz7wPeTf5B6>

6

Pallati i Rinisë - barnatorja e përkohshme e Labororit mikrobial të së ardhmes

<https://maps.app.goo.gl/sxUEA89YE9KoG4Gr6>

7

Parku i Qytetit

<https://maps.app.goo.gl/mKC323ixLbgkXg2T7>

8

Shtëpia e të moshuarve

<https://maps.app.goo.gl/sMXstVXuBmkgVRME7>

9

Instituti Francez i Kosovës, rr. Sejdi Kryeziu nr. 8

<https://maps.app.goo.gl/xFH9gTVAU4BnnyqZ9>



8

7

2

3

5

9

1

4

6



PLATFORMA EVROPIANE PËR KRIJIMTARI ARTISTIKE NË HAPËSIRA PUBLIKE

IN SITU është Platforma evropiane për krijimtari artistike në hapësira publike. Që nga viti 2003, ka përkrahur rreth 300 artistë që punojnë jashtë sallave konvencionale dhe që kontribuojnë në transformimin e territoreve tona. IN SITU është një ekosistem që lidh gjeneratën e re të artistëve me publikun, programuesit dhe akterët kyç të përfshirë në realitetet ekonomike, politike e sociale rreth e përqark Evropës.

IN SITU udhëhiqet nga Lieux Publics, qendër nacionale dhe evropiane për krijim artistik në hapësirë publike e vendosur në Marsejë (Francë) dhe bashkon 18 partnerë nga 13 vende: Artopolis Association (Hungari), Atelier 231 (Francë), Čtyři Dny / Four Days (Çeki), FiraTàrrega (Spanjë), Freedom Festival (Mbretëri e Bashkuar), Flynn Center for the Performing Arts (SHBA), La Strada (Austri), Lieux publics (Francë), Metropolis (Danimarkë), Norfolk & Norwich Festival (Mbretëri e Bashkuar), Oerol Festival (Holandë), Østfold Internasjonale Teater (Norvergji), Teatri ODA (Kosovë), Provinciaal Domein Dommelhof (Belgjikë), Scène Nationale De L'Essonne Agora-Desnos (Francë) dhe një konzorcium prej partnerësh italianë: Zona K, Indisciplinarte, Teatro Stabile Di Sardegna. IN SITU gjithashtu bashkon edhe 13 partnerë të asociuar: Cifas (Belgjikë), FAI-AR (Francë), Anti Festival (Finlandë), Biela Noc (Sllovakë), Bússola (Portugali), Bildstörung – Festival for performing arts in public

spaces (Gjermani), Tombées de la Nuit (Francë), Hoooh – Tainan Street Arts (Tajvan), Linhai Art Festival & Start Festival (Kinë), Seoul Street Arts Festival (Kore e Jugut), Sura Medura (Shri Lankë), The SPOT Festival (Lituani). Projekti (UN)COMMON SPACES 2020 – 2024 është bashkë-financuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian.

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbajnë përgjegjësi për to.



Co-funded by
the European Union



www.in-situ.info



INSITUnetwork



insituplatform



IN_SITU_Network





Shtëpia e të moshuarve

E mërkurë, 28 gusht 2024 / nga ora 10:00

E enjte, 29 gusht 2024 / nga ora 10:00

Sauf Le Dimanche (FRANCË)

BALADË

Një performancë koreografike për shtëpitë e të moshuarve

Një dyshe kërcimtaresh nga Franca kalojnë dy ditë në shtëpinë e të moshuarve.

Një surprizë e vogël pas mëngjesit, dy valltare janë aty.

Për dy ditë, ka mjaftueshëm kohë për t'i dhënë gjithsecilit hapësirë për të gjetur ritmin e tij apo të saj, për të vëzhguar në mënyrë që të krijohet besim, për të shijuar menjëherë, për të mundur më pas të pushohet. "Baladë" shumëfishon mënyrat e hyrjes në kërcim: të jesh spektator i privilegjuar i një kërcimi në dhomën tënde, në privatësi të plotë; ose për të marrë pjesë në një punëtori lëvizjesh, e krijuar në mënyrë që të gjithë të mund të lëvizin, pavarësisht nga shkalla e lëvizshmërisë; e përshtatur për të gjitha shkallët e lëvizshmërisë, apo për të lejuar veten në lojën e kërcimit duke imituar kërcimtarët në hapësirën e përbashkët; apo për të qeshur me gëzimin e shikimit të një improvizimi që zhvillohet nga tryeza e darkës.

Në një mënyrë të papritur, duke përdorur taktin dhe humorin, një puhizë e butë - që bart elementet - vallëzimi, bukuria dhe lehtësia - përshkohet nëpër shtëpi. Vetëm të shikosh trupat duke kërcyer është si të vallëzosh vetë! Dhimbjet dhe frika e humbjes së ekuilibrit, të gjitha këto largohen nga vetë lëvizja.

Në fund të kësaj përvoje, të gjithë banorët, stafi dhe familjet ftohen të mbledhen për të parë një performancë 30-minutëshe. Secili prej tyre njihet, duke kujtuar kohët e mira të kaluara së bashku.



Foto: Marielle Rossignol

Krijuese dhe kërcimtare: **Emilie Buestel, Marie Doiret**

Artiste pamore, skenografe: **Sidonie Morin**

Kompozimi muzikor: **Sébastien Berteau**

Kostumografia: **Cécile Madry**

Artisti pamor: **Auréli Buridan**

saufledimanche.com



Co-funded by
the European Union

Sauf Le Dimanche janë artistë të asocuar të IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahet nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), FiraTàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 3 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinarte, Teatro Stabile Di Sardegna.

Mbështetur nga:



2 rr. Nëna Tereze (te Ministria e Kulturës)

E mërkurë, 28 gusht 2024 / Ecja e shoqëruar- ora 16:00

E enjte, 29 gusht 2024 / Ecja e shoqëruar- ora 16:00

E premte, 30 gusht 2024 / Ecja e shoqëruar- ora 15:00

Rituali performativ final -ora 17:30

Florent Golfier (ÇEKI)

ATLAS

Atlasi është një kameleon subversiv. Ata janë klloun shumë-polar me një mijë hundë. Ata kanë një nevojë të madhe për komunikim dhe kontakt me njerëz të tjerë, me të cilët kërkojnë mundësi për dialog të pakontrolluar për tema ekologjike dhe sociale.

Atlasi ju mirëpret para Ministrisë së Kulturës në rrugën Nënë Tereza, në zyrën e tyre të improvizuar pranë koshit të mbeturinave dhe ju fton për një ecje të shoqëruar prej rreth 60 minutash për të mësuar më shumë rreth aktivizmit të kllounëve, si të miqësoheni me pëllumbat, drunjtë dhe krijesat e tjera, se si koncepti i 'Gravity Strike' mund të bëhet një mjet për ndryshimin sistemik që bota dëshpërimisht ka nevojë. Së fundi, në ditën e fundit, një ritual performativ do të kremtojë përfundimin e vizitës së Atlasit në Prishtinë.

Shkoni dhe zbuloni kllounin Atlasin para Ministrisë së Kulturës në Nënë Tereza dhe bashkohuni me ta në këtë zbulim.



Foto: Adam Holubovskí

Autor, performues: **Florent Golfier-Brechmann**

Bashkë autorë, dramaturgë: **Laura Golfier-Brechmann, Ondřej Holba**

Produksioni: **tYhle, Ludmila Šindlerová**

Partnerë të projektit: **Studio ALTA, Rezi.dance Komařice, Moving Station Pízeň, Terén**

tyhle.cz

Atlasi u krijua më 2021 me mbështetje financiare të Ministrisë së Kulturës të Republikës Çeke, Qytetit të Pragës, Bashkisë së Qytetit të Bërnos dhe Fondit Shtetëror Kulturor.



MINISTERSTVO
KULTURY



B | R | N | O



Státní fond kultury ČR



NÁRODNÍ
PLÁN OBNOVY



Financováno
Evropskou unií
NextGenerationEU

Më 2024, projekti u implementua me pjesëmarrje financiare të BE përmes Planit Kombëtar të Rimëkëmbjes, si pjesë e projektit 'tYhle on the road'.



Co-funded by
the European Union

Prezentimi në Prishtinë i Atlas nga Florent Golfier u përkrah nga IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian.



Foto: Simona Rybova



Pallati i Rinisë -Lokali nr.036 - barnatorja e përkohshme e Laboratorit mikrobial të së ardhmes

E mërkurë, 28 gusht 2024 / Barnatorja e përkohshme nga 12:00 - 18:00

E enjte, 29 gusht 2024 / Barnatorja e përkohshme nga 12:00 - 18:00

E enjte, 29 gusht 2024 / Punëtorja e Mjekësisë së të ardhmes nga 18:00 - 19:30

E premte, 30 gusht 2024 / Barnatorja e përkohshme nga 12:00 - 18:00

E premte, 30 gusht 2024 / Punëtorja e Mjekësisë së të ardhmes nga 18:00 - 19:30

Eva Bubla (HUNGARI)

LABORATORI MIKROBIAL I SË ARDHMES

Çfarë kanë të bëjnë një grusht dheu, pylli, gjelbërimi i qyteteve, apo disa krijesa të padukshme me shëndetin e trupave tanë njerëzor dhe më shumë se njerëzor?

Laboratori mikrobial i së ardhmes është një laborator udhëtues, një koleksion vazhdimisht në rritje të ilaçeve të së ardhmes, trajtimeve, riteve dhe narrativeve që pasqyrojnë mbi mirëqenien e formave të jetës njerëzore dhe atyre më shumë se njerëzore. Të gjitha trupat janë ekosisteme mikrobiale të ndërlidhura, habitate të organizmave të vegjël që jetojnë dhe frymojnë: trupa të qyteteve, trupa të ujërave, ajrit, dhe dheut, si dhe trupat tanë njerëzorë janë të pandashëm.

Si mund ta imagjinojmë ilaçin e së ardhmes në një botë ku gjendja e mjedisit tonë dhe marrëdhënia jonë aktuale me të është e komprometuar? Çfarë vizionesh spekulative për të ardhmen, rite të vjetra e të reja, trajtime dhe ilaçe mund të imagjinojmë nëse e shikojmë konceptin e shëndetit në një mënyrë holistike, nëse e kuptojmë atë si mirëqenie e ndërsjellë e formave të jetës njerëzore dhe atyre më shumë se njerëzore që jetojnë në mënyrë simbiotike? Gjatë Festivalit HAPU, barnatorja e përkohshme e Laboratorit shfaq

koleksionin e ilaçeve dhe trajtimeve, peisazhe të kapsuluara, pika mikrobiale dhe historitë e pacientëve të ndryshëm jo të rregullt - qytetet, lumenjtë, atmosferat. Gjatë punëtorive të Mjekësisë së të ardhmes, publiku ftohet të spekulojë bashkërisht për të ardhmen e Prishtinës duke dizajnuar rite dhe ilaçe të reja për format e ndryshme të jetës që e popullojnë atë.



Foto: Pedro Morato Gabao & Bryan Lassudry

Kohëzgjatja e punëtorisë e Mjekësisë së të ardhmes: **90 minuta**

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar për një sesion.

Ju lutemi rezervoni vendin tuaj duke na shkruar në teatrida@gmail.com me ditën dhe orën që dëshironi të merrni pjesë ne punëtori.

Punëtorija është në gjuhën angleze me përkthim në shqip.

Ky projekt i ka rrënjët në bashkëpunimin me hulumtuesit e Microbial Childhood Collaboratory (MCC) në Universitetin e Tampere, Finlandë.

evabubla.art



Co-funded by
the European Union

Eva Bubla është artistë e asocuar e IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahet nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), FiraTàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 3 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinate, Teatro Stabile Di Sardegna.

E mërkurë, 28 gusht 2024 / 15:00

E enjte, 29 gusht 2024 / 15:00

E premte, 30 gusht 2024 / 15:00

600 HIGHWAYMEN (NEW YORK, USA)

MIJËRA MËNYRA: NJË ASAMBLE

Shkruar dhe krijuar nga Abigail Browde dhe Michael Silverstone

Një performancë qytetare e krijuar nga të panjohurit.

Artistët nga Nju Jorku, 600 Highwaymen, prezantojnë MIJËRA MËNYRA: NJË ASAMBLE, një analizë intime se sa të vegjël jemi përballë forcave natyrore mahnitëse si dhe varësisë tonë të ndërsjellë. Duke përdorur një skenar të përbashkët, ku 16 anëtarë të publikut bashkohen për një orë për të ndërtuar një rrëfim evokues të këmbëngulësisë dhe rrënimit. Ky projekt intim dhe i kohës eksploron kufirin mes së panjohurës dhe lidhjes, largësisë dhe afërsisë, dhe se si një akti i mbledhjes shumë intim mund të bëhet thellësisht radikal.

Ky projekt i veçantë për të panjohurit, "... merr një premisë të thjeshtë dhe e kthen në magji." - New Yorker

Kjo përvojë inskenohet nga ju dhe anëtarët e tjerë të publikut. Udhëzimet për performancën janë të shkruara në anglisht në kartolina 10x15cm dhe anëtarët e publikut lexojnë atë që është shkruar në to. Kartolinat janë të shkruara në një tipografi 15 pikëshe në ngjyrë të zezë dhe të kaltër mbi një sfond të bardhë.



Foto: West Smith at On the Boards, Seattle / @1800westsmith

Kohëzgjatja është **70 minuta**.

Mosha për pjesëmarrje është **16 vjeç** e më shumë.

Nuk lejohen hyrjet me vonesë.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar për një sesion.

Ju lutemi rezervoni vendin tuaj duke na shkruar në teatrioda@gmail.com me ditën që dëshironi të merrni pjesë.

600highwaymen.org



Co-funded by
the European Union

600 Highwaymen janë artistë të asocuar të IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahët nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), FiraTàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 3 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinarte, Teatro Stabile Di Sardegna.

2 rr. Nëna Tereze (te Ministria e Kulturës)

E mërkurë, 28 gusht 2024 / ora 16:30

E mërkurë, 28 gusht 2024 / ora 18:30

E enjte, 29 gusht 2024 / ora 16:30

E enjte, 29 gusht 2024 / ora 18:30

ELECTRICO 28 (SPANJË, AUSTRI)

[KORNIZA]

[Korniza] ju fton të uleni përballë jetës së përditshme për ta vëzhguar atë. Ka karrige, vështrime, fjalë, shenja, zëra, tinguj, asfalt, disa pemë e shumë gjëra të tjera. Ka shumë personazhe. Katër prej tyre janë trajnuar në disiplinat e observimit dhe përshkrimit. Të tematizuar nga marramendja e jetës së përditshme, ata përpiqen të kapin gjithçka që ndodh për 50 minuta. Nuk ka skenar. Nuk ka përfundim. [Korniza] ka të bëjë me shumë specie të hapësirave - është lozonjare dhe poetike, është një hapësirë për veprime befasuese e spontane dhe për takime rastësore. Është gjithashtu mënyrë për të takuar të zakonshmen, banalen dhe të

përgjithshmen, për të zbuluar të jashtëzakonshmen, të veçantën dhe uniken.



Foto: Nikola Milatovic

Kohëzgjatja është **50 minuta**.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar për një sesion.

Për të rezervuar vendin tuaj, ju lutemi na shkruani në teatrioda@gmail.com me një shënim për datën dhe orën e dëshiruar për ju.

electrico28.org

Bashkë-prodhuar nga: theaterland steiermark, Fira Tàrrega, Eléctrico Express

Përkrahur nga: Generalitat de Catalunya(Cultura) ICEC; Das Land Steiermark; Stadt Graz

Në bashkëpunim me: das andere theater, Escena Poblenou, Centre Cívic Can Felipa, Can Allá



Foto: Clemens Nestroy



Co-funded by
the European Union

Electrico 28 janë artistë të asocuar të IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahet nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), FiraTàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 3 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinate, Teatro Stabile Di Sardegna.

4

Pallati i Rinisë - Shkallët brenda qendrës tregtare

*E mërkurë, 28 gusht 2024 / ora 20:30**E mërkurë, 28 gusht 2024 / ora 21:00**E mërkurë, 28 gusht 2024 / ora 21:30*

Donika Rudi (KOSOVË, BELGJIKË)

OKUPO AJRIN (VAJTIMI I TOKËS II)

Pjesa e dytë e ciklit audio-vizual "Vajtimi i tokës", "Okupo ajrin" i kompozuar për fizarmonikë dhe elektronikë, trajton çështjen dhe veprimin urgjent kundër ndotjes së ajrit dhe shmangien e ndryshimeve klimatike. "Okupo ajrin" ndjek strukturën e pjesës së parë të ciklit, frymëzuar nga shiritat e ngrohjes që përfaqësojnë rritjen e temperaturave globale ndër vite.

Në vitet e fundit, Donika përkushtohet që veprat e saja të jenë gjithëpërfshirëse dhe temën e ndryshimeve klimatike ta vendos në fokus duke ngre zë përmes kompozimeve të saja akuzmatike dhe elektroakustike. "Okupo ajrin" trajton çështjen dhe problematikën e ndotjes së ajrit, duke kërkuar me ngulm rritjen

e ndërgjegjësimit për shëndetin publik dhe mjedisin.

Kohëzgjatja është 10 minuta.





Kompozitore: **Donika Rudi**
Fizarmonikë: **Margherita Berlanda**
Teksti: **Doruntina Basha**

Narrator: **Victor Andrini**
Kostumi: **Hana Zeqa**
Zëri: **Labinot Rudi**

<http://donikarudi.com/>



Co-funded by
the European Union

Donika Rudi është artistë e asocuar e IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahet nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), FiraTárrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 3 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinarte, Teatro Stabile Di Sardegna.

5 *E premte, 30 gusht 2024 / ora 16:30 / Sheshi Zahir Pajaziti (para hotelit Grand)*

2 *E premte, 30 gusht 2024 / ora 18:30 / rr. Nëna Tereze (te Ministria e Kulturës)*

Sauf Le Dimanche (FRANCË)

TROK!

Një gjest për një kërcim!

Nga një gjest i juaji te kërcimtarët, ato frymëzohen dhe ju dhurojnë një kërcim. Kjo kohë intime prej 1 minutë e 30 sekondash është posaçërisht për ju. Ejani dhe përjetoni këtë takim dhe takoni dyshen e kërcimtareve nga Franca. Ato kanë kaluar në shumë sheshe, tregje, salla dhe kënde lojërash, në Francë dhe vende tjera. Ato janë treguar bujare me të rriturit, me fëmijët dhe me gjithë ata që kanë ardhur për t'i parë, madje edhe me kalimtarët e rastit.

Ato do të marrin atë që ju dëshironi ta ndani me to dhe do t'ju kthejnë shumë: ndoshta gjesti juaj vjen para fundit të sekuencës; një reagim i vonuar i mbushur me 1000 gjeste; një gjest i turpshëm i dhënë si një dhuratë e çmuar dhe e brishtë; një gjest që menjëherë ndjehet që përmban një rrëfim, një sekret - një sekret që shpesh zbulohet nga kërcimtarët pas kërcimit, një "jo" e fortë! e shqiptuar qoftë edhe para përfundimit të shfaqjes.

Gjatë kërcimit zona është plot zhurmë, jeta rreth nesh vazhdon, një kalimtar provon një hap kërcimi për t'u përfshirë, të tjerët ndalojnë për t'i lëshuar një sy, të tjerë kalojnë me nxitim me kokën ulur. Disave u pëlqen muzika, e të tjerët kurrë nuk kanë dëgjuar muzikë të tillë më parë.

Në fund të kërcimit, do të ketë falënderime për njëri-tjetrit, duke zbuluar ndjenjën e mahnitshme për të pranuar një kërcim vetëm për ju.



Foto: Frank Emmers

Krijueset e projektit dhe kërcimtare: **Emilie Buestel, Marie Doiret**
Skenografia: **Caroline Ginot**
Dizajni grafik: **Pierre Jeanneau.**
Në partneritet me **Réseau en scène Languedoc-Roussillon and the
Conseil Départemental des Hauts de Seine**

sauflledimanche.com



Co-funded by
the European Union

Sauf Le Dimanche janë artistë të asocuar të IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahët nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), FiraTàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 3 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinate, Teatro Stabile Di Sardegna.

Mbështetur nga:



3 Sheshi Zahir Pajaziti (Amfiteatri)

E premte, 30 gusht 2024 / ora 19:00

E premte, 30 gusht 2024 / ora 21:00

E shtunë, 31 gusht 2024 / ora 21:00

Juan Ignacio Tula (FRANCË, ARGJENTINË)

L'INSTANT T!

Juan Ignacio Tula krijoi një performancë të quajtur "Instante", një rezultat i eksplorimit të thellë me objektin e tij të obsesionit, rrotën. Sot, artisti ju ofron një formë të dedikuar për hapësirë të hapur ku "Instante" pëson një metamorfozë të vazhdueshme në "Instant-T," duke u krijuar si material bazë për një transformim të përhershëm.

Mes trazirave të kërcimit, zhytmi në një ekstazë, në një kërkim të pafund për lidhje universale e personale që mund t'i ndajmë së bashku. Në thjeshtësinë e një lëvizjeje rrotulluese e të përsëritur, gjesti i cirkut na drejton drejt një kërcimi dervishësh; nga verbëria e shkaktuar nga spiralet, lind instinkti i mbijetesës, ku trupi angazhohet plotësisht, duke iu afruar pikës së kthesës, ku gjithçka bëhet e pafundme.



Foto: Anita Cortes



Foto: Anita Cortes

Krijuar dhe performuar nga: **Juan Ignacio Tula**

Zëri: **Gildas Céleste**

Teknika: **Célia Idir**

Kostumet: **Adèle Giard**

Produksioni dhe turneu: **Kevin-Gabriel Fricot , Andréa Petit-Friedrich - Triptyque Production**

Administrata: **Anne Delépine**

cie7bis.fr



Co-funded by
the European Union

Juan Ignacio Tula ka pranuar 'Ndihmë në krijim' dhe mbështetet nga IN SITU, Platforma evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Mbështetur nga:





Parku i Qytetit

E shtunë, 31 gusht 2024 / ora 10:30

E shtunë, 31 gusht 2024 / ora 12:30

E shtunë, 31 gusht 2024 / ora 16:00

Cristina Maldonado (ÇEKI, MEKSIKO)

LOJA E PAFUNDME

Bashkohuni lojës në të cilën nuk ka humbës apo fitues, lojës që nuk ka fillim apo fund!

Në këtë meditim prej 60 minutash, ju do të përfshihenit në një udhëtim të brendshëm përmes përvojave dhe historive të mbledhura në vende të ndryshme dhe nga biseda me arkeologë, drejtues funeralesh, aktivistë, kuratorë dhe artistë.

Të ulur në tryezë, me të tjerët, por në introspeksion, ne do të meditojmë mbi kujtesën, përjetësinë dhe fundshmërinë. Ne do t'ju ftojme të dëgjoni, shkruani, lexoni, ndjeni dhe mendoni me trupin tuaj, në një udhëtim introspektiv që do t'ju çojë të gjeni vendin tuaj në ciklet e lojës së pafundme.

'Infinite Game' u krijua në kuadër të 'Invisible Bonds: Performativity of Death in the Everyday' të katër viteve të hulumtimit artistik të Maldonados në vende të ndryshme e që bazohet në njohuritë lokale për të krijuar përvoja kritike përfshirëse me synimin për të rikuperuar intimitetin me fundshmërinë tonë dhe me ciklet natyrore, pjesë e së cilës jemi edhe ne.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar për një sesion.

Për të rezervuar vendin tuaj, ju lutemi na shkruani në teatrioda@gmail.com me një shënim për orën e dëshiruar për ju.



Foto: Dani Hernández Marin



Zhvillimi i projektit: **Světlna Silich, Cristina Maldonado, Marine Frugès.**
Këshillues: **Cooperative Funeraire de Rennes, À bout du Plongeoir and Fira Tarrega.**

Performues: **Světlna Silich, Cristina Maldonado, Marine Frugès, Bleuenn Pasco and Manon Gloro**

Zëri origjinal: **Theresa Schrezenmeir**

Adaptimi i zërimet dhe implementimi teknik: **Joan Cot Ros**

Bendi i frymorëve: **La Follia**

Rrëfime nga: **Icela Bravo, Eva Rosmarijn and Gaby Kiss and current events from the city of Tàrrega**

Zërat: **Theresa Schrezenmeir, Eva Rosmarijn, Laila Romo, En-Ping Yu**
Produksioni: **GALA Global Arts and Leadership Alliances, Dali Estrada and Gisel Vergara**

Performanca e zhvilluar me përkrahjen e Atelier 231, Čtyři Dny dhe Fira Tarrega

Fotografia: **Dani Hernández Marin**



Co-funded by
the European Union

Cristina Maldonado është artistë e asocuar e IN SITU, Platformës evropiane për krijimtari artistike në hapësirë publike, në kuadër të projektit (UN)COMMON SPACES, të bashkëfinancuar nga Programi "Evropa kreative" i Bashkimit Evropian. Programi i Artistit të Asocuar përkrahet nga Artopolis Association (HU), Atelier 231 (FR), Čtyři Dny / Four Days (CZ), FiraTàrrega (ES), Flynn Center (USA), Freedom Festival (UK), La Strada (AT), Lieux publics (FR), Metropolis (DK), Norfolk & Norwich Festival (UK), Oerol Festival (NL), Østfold Internasjonale Teater (NO), Oda Teatri (XK), Provinciaal Domein Dommelhof (BE), Scène Nationale De L'Essonne (FR) dhe konsorciumi i 3 partnerëve italianë: Zona K, Indisciplinarte, Teatro Stabile Di Sardegna.

1 Teatri ODA

E shtunë, 31 gusht 2024 / 21:30h

ZWADA (KOSOVË)

KONCERTI PËRMBYLLËS I EDICIONIT TË DHJETË TË HAPU.

ZWADA është bend që përbëhet nga Suada Abazi (vokal / kitarë), Lum Veseli (bateri), Orges Kurtaj (bas kitarë) dhe Andi Sadiku (kitarë). Pjesë e skenës së muzikës alternative në Kosovë, ata janë një bend eksperimental e jo statik, të etur për të zbuluar dhe ri zbuluar rrjedhat e muzikës. Edhe pse të inspiruar nga indie rock, punk dhe muzika alternative, ata nuk e fusin veten në një kategorizim, por kanë për qëllim të rrjedhin plotësisht nëpër rrymat e muzikës.

[instagram.com/zwadaa](https://www.instagram.com/zwadaa)



NA U BASHKONI TË FESTOJMË MBYLLJEN E
EDICIONIT TË DHJETË TË HAPU ME ARTISTËT,
EKIPIN, VULLNETARËT, MIQTË, SHIKUESIT DHE
PËRKRAHËSIT.

**TË GJITHË JANË TË
FTUAR!**



HAPU - Festivali i Artit në Hapësirë
Publike organizohet nga Teatri
ODA:



Pallati i Rinisë, 111 (Rinia, 7),
10030 Prishtinë, Kosovë

www.teatrioda.com

T: +383 38 246 555

M: +383 49 246 555

E: oda@teatrioda.com

  [teatrioda](https://www.facebook.com/teatrioda)

Drejtor Artistik: Florent Mehmeti
Ekipi i festivalit: Daniela Markaj (koordinatore),
Diana Markaj, Sabi Paqarizi, Monika Shtufi
Ekipi teknik: Yann Perregaux-Dielf, Mursel
Bekteshi, Bujar Bekteshi, Adem Salihu
Administrata: Lumnije Komoni

Ky publikim reflekton qëndrimet vetëm të autorëve. Donatorët dhe mbështetësit nuk mbajnë përgjegjësi për çfarëdo përdorimi të informatave që përmban ky publikim.

hapu.me   [hapufest](https://www.instagram.com/hapufest)

Mbështetur nga:



Republika e Kosovës
Ministria e kulturës, rinisë dhe sportit



ADS D-LINE  VM3

Sponsorizuar nga:



LACALUT

Sponsor medial:



 kultplus



